



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR Durrës**

Nr. 304 prot.

Durrës, më 28.01.2021

Lënda: Raporti i Monitorimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2020

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PROGRAMIMIT DHE**  
**ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT**

**Tiranë**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë:

- 1- Raportin e Monitorimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2020
- 2- Relacionin shoqërues të monitorimeve

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës,

**ZV/KRYETAR**  
**MARKELIAN KOÇA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR Durrës**

Lënda: Relacioni shoqërues i Monitorimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2020

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ju raporton mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar- Dhjetor 2020.

**Programi - “Buxheti Gjyqësor”**

Buxheti i akorduar për këtë program ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2020-2022. Ky program konsiston në mbështetjen buxhetore të shërbimeve gjyqësore dhe përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave, me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së ngjashme me vendet e Bashkimit Europian.

Buxheti i alokuar në këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi është të ndërtojë, udhëheqë dhe qeverisë një gjyqësor me performancë të lartë, që kërkon ekselencë dhe meriton besimin e publikut.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

**Aneksi nr. 1 - Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve për periudhën Janar – Dhjetor 2020.**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës është pjesë vetëm e një programi, Programit “Buxheti Gjyqësor”

**Aneksi nr. 2 - Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas artikujve buxhetorë për periudhën Janar – Dhjetor 2020.**

Me Ligjin "Për Buxhetin e vitit 2020", fondet e akorduara për funksionimin e aktivitetit të gjykatave, sipas artikujve, paraqiten në vijim:

**1-Shpenzime Personeli**

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Dhjetor 2020 për mbulimin e shpenzimeve në paga dhe sigurime shoqërore është 80'200 mijë lekë. Realizimi paraqitet në masën 80'149 mijë lekë ose 99.94 % e buxhetit të planifikur.

Numri i punonjësve sipas strukture së miratuar është 53 punonjës ndërsa numri në fakt është 47 punonjës.

Numri i gjyqtarëve sipas planit është 17 gjyqtar së bashku me Kryetarin, por në fakt janë 13 gjyqtarë dhe 1 Zv/Kryetar.

Gjatë periudhës 2017-2020, 4 gjyqtarë janë larguar, 1 gjyqtar është në pritje të vendimit të raundit të dytë të vetingut dhe është transferuar në gjykatën tonë nga Gjykata e Krimeve të Rënda dhe 1 gjyqtarë është në proces gjyqësor .

## **2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera**

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Dhjetor 2020 është 11'985 mijë lekë.Realizimi i këtij artikulli paraqitet në vlerën 11'678 mijë lekë ose 97.43 % e buxhetit të planifikuar.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020 kanë përfunduar të gjitha procedurat e parashikuara për 12 muajt e 2020 si letër, kancelari, material pastrimi, internet, karburantit, fashikujve etj.

## **3. - Shpenzime në investime**

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për periudhën Janar – Dhjetor 2020 është 13'655 mijë lekë, e ndarë kjo në 10'300 mijë në fonde për projekt ndërtese dhe 3'355 mijë në investime të tjera.

Realizimi i këtij artikulli është në masën 2'585 mijë lekë ose 18.93 %, arsyet e detajuara për cdo produkt janë sqaruar më poshtë. Ato lidhen me vështirësitë e krijuara nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia e Covid-19.

Fondi prej 720 mijë lekë i planifikuar për pajisje mobilje dhe bateri serveri është realizuar plotësisht në vlerën 433 mijë lekë.

Procedura me fond prej 2'250 mijë lekë e planifikuar për blerje pajisje elektronike është realizuar plotësisht në vlerën 2'151 mijë lekë

Fondi prej 10'300 lekë i planifikuar për projektin e ndërtesës së re është pezulluar me vendim të KLGJ me Shkresën nr.2944, datë 21/07/2020.

Fondi prej 385 mijë lekë planifikuar për dëmtimet e tërmetit të Nëntor 2019 i cili është bërë aktiv në Gusht 2020 nuk është realizuar sepse: së pari ka ardhur me vonesë dhe Gjykata mund ti bënte këto punime vetëm gjatë gushtit kur janë lejet e zakonshme dhe si rezultat i kësaj vonese dhe duke qënë se dëmtimet e tërmetit kanë qënë në vlerë të vogël ato janë mbuluar nga llogaria shpenzime për mirmbajtje godine 602 në Korrik 2020 fonde këto të parashikuara në buxhet në fillim të vitit.

Në datën 24.09.2020 me shkresën nr.2496 prot., datë 24.09.2020 i kemi bërë kërkesë KLGJ për transferim e këtij fondi prej 385 mijë lekë në zëra të tjerë të investimeve sipas nevojave të argumentuara nga ana jonë por, kjo kërkesë nuk na është miratuar.



**Aneksi nr. 3 - Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit për periudhën Janar – Dhjetor 2020.**

Programi “Buxheti Gjqësor” për periudhën Janar – Dhjetor 2020 përbëhet nga produkti A “Çështje të gjykuara”, i cili është në funksion të realizimit të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP). Realizimi sasior paraqitet si më poshtë:

**Produkti A “Çështje të gjykuara në vit”**- Njësia matëse nr.çështjesh.

Numri i çështjeve të parashikuara për periudhën Janar - Dhjetor 2020 është 7'000. Ky parashikim nga ana e gjykatës është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite. Për këtë periudhë janë gjykuar plotësisht 6'631 ose 94,72% të çështjeve të planifikuara.

Nga një këndvështrim i përgjithshëm, në realizimin sasior të këtij produkti duhet të merren në konsideratë fakti se në realizimin e çështjeve gjyqësore ndikojnë një sërë faktorësh të natyrës proceduriale apo substanciale që paraqiten specifike për çdo çështje. Gjithashtu këtë vit duhet të mbahet parasysh pandemia e Covid-19.

**Produkti F – “Mobilje për zyra dhe salla gjyqipër gjykatat”.** Fondi i akorduar për këtë artikull nga Buxheti i Shtetit për periudhën Janar- Dhjetor 2020 është 600 mijë lekë. Kjo blerje përfshin 6 poltrona gjyqtarësh, 6 tavolina pune gjyqtarë, 6 sirtarjere(komedina).

Ky artikull është realizuar plotësisht dhe likujdimi i këtij artikulli është në vlerën 326 mijë lekë.

**Produkti K – “Pajisje elektronike për Gjykatën”** Fondi i akorduar për këtë artikull nga Buxheti i Shtetit për periudhën Janar- dhjetor 2020 është 2'250 mijë lekë. Kjo blerje përfshin 4 kompjutera, 2 tabletë, 1 laptop, 5 printera, 10 ups, dhe 1 fotokopje.

Ky artikull është realizuar plotësisht dhe likujdimi i tij është në vlerën 2'150 mijë.

**Produkti H – “Pajisje të tjera për Gjykatën”** Fondi i akorduar për këtë artikull nga Buxheti i Shtetit për periudhën Janar- dhjetor 2020 është 120 mijë lekë. Kjo blerje përfshin 3 bateri serveri.

Realizimi është i plotë dhe likujdimi i këtij artikulli është 107 mijë lekë

Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës,

  
ZV/KRYETAR  
MARKELIAN KOÇA

ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

Periudha Janar- DHJETOR 2020

ne 000/leke

| Shpenzimet e Institucionit               |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
|------------------------------------------|------------------|-------------------------------|--------------------------|------------------------------|-----------------------------------|-----------|-----------------------------------------------|--------------------------------------------------|------------------------------|
| Programet                                |                  | (1)<br><br>Fakti viti<br>2019 | (2)<br><br>PBA viti 2020 | (3)<br><br>Buxheti viti 2020 |                                   |           | (5)<br><br>Plani i<br>Periudhes/pro<br>gresiv | (6)<br><br>Fakti<br>i<br>Periudhes/prog<br>resiv | (7)=(6)-(5)<br><br>Diferenca |
|                                          |                  |                               |                          | Plani<br>fillestar           | Plani<br>rishikuar<br>gjate vitit | Plani i   |                                               |                                                  |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
| Titulli                                  | Emertimi         |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
| 03310                                    | Buxheti Gjyqësor | 94.173,0                      | 107.020,0                | 107.020,0                    | -1.136,0                          | 105.884,0 | 94.454,0                                      | -11.430,0                                        |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
|                                          |                  |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
| .....                                    | .....            |                               |                          |                              |                                   |           |                                               |                                                  |                              |
| Totali i Shpenzimeve te Ministrise       |                  | 94.173,0                      | 107.020,0                | 107.020,0                    | -1.136,0                          | 105.884,0 | 94.454,0                                      | -11.430,0                                        |                              |
| Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit |                  | 1.481,00                      | 1.300,00                 | 1.300,00                     | 0,00                              | 1.048,00  | 902,00                                        | -146,0                                           |                              |
| Totali                                   |                  | 95.654,0                      | 108.320,0                | 108.320,0                    | -1.136,0                          | 106.932,0 | 95.356,0                                      | -11.576,0                                        |                              |

|                                         |       |                                                                                       |
|-----------------------------------------|-------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| Nepunesi Autorizues/Kryetari i Gjykates | Emri  |   |
|                                         | Firma |  |
|                                         | Data  |                                                                                       |



Republika e Shqipërisë  
Këshilli i Lartë Gjyqësor  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetorë"

Periudha Janar- DHJETOR 2020

ne 000/leke

| Programi                                                     | Buxheti Gjyqesor               | Kodi i Programit 03310    |                         |                          |                                   |                                    |                         |           |     |  |                                              |                              |
|--------------------------------------------------------------|--------------------------------|---------------------------|-------------------------|--------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|-------------------------|-----------|-----|--|----------------------------------------------|------------------------------|
| Art.                                                         | Emertimi                       | (1)<br>Fakti viti<br>2019 | (2)<br>PBA viti<br>2020 | (3)<br>Buxheti viti 2020 |                                   |                                    | (4)                     |           | (5) |  | (6)<br>Fakti<br>i<br>Periudhes/progr<br>esiv | (7)=(6)-(5)<br><br>Diferenca |
|                                                              |                                |                           |                         | Plani<br>fillestar       | Plani<br>rishikuar<br>gjate vitit | Plani i<br>Periudhes/prog<br>resiv | Plani i                 |           |     |  |                                              |                              |
|                                                              |                                |                           |                         |                          |                                   |                                    | Periudhes/prog<br>resiv |           |     |  |                                              |                              |
| 600                                                          | Paga                           | 71.716,0                  | 76.000,0                | 76.000,0                 | -3.700,0                          | 72.300,0                           | 72.294,0                | -6,0      |     |  |                                              |                              |
| 601                                                          | Sigurime Shoqërore             | 7.994,0                   | 7.750,0                 | 7.750,0                  | 150,0                             | 7.900,0                            | 7.855,0                 | -45,0     |     |  |                                              |                              |
| 602                                                          | Mallra dhe Shërbime të Tjera   | 12.449,0                  | 10.000,0                | 10.000,0                 | 1.986,0                           | 11.986,0                           | 11.678,0                | -308,0    |     |  |                                              |                              |
| 606                                                          | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 283,0                     |                         | 0,0                      | 43,0                              | 43,0                               | 43,0                    | 0,0       |     |  |                                              |                              |
| Nen-Totali                                                   | Shpenzime Korrente             | 92.442,0                  | 93.750,0                | 93.750,0                 | -1.521,0                          | 92.229,0                           | 91.870,0                | -359,0    |     |  |                                              |                              |
| 230                                                          | Kapitale të Patrupëzuara       | 0,0                       | 0,0                     | 0,0                      | 0,0                               | 0,0                                | 0,0                     | 0,0       |     |  |                                              |                              |
| 231                                                          | Kapitale të Trupëzuara         | 1.731,0                   | 13.270,0                | 13.270,0                 | 385,0                             | 13.655,0                           | 2.584,0                 | -11.071,0 |     |  |                                              |                              |
| Nen -Totali                                                  | Shpenzime Kapitale             | 1.731,0                   | 13.270,0                | 13.270,0                 | 385,0                             | 13.655,0                           | 2.584,0                 | -11.071,0 |     |  |                                              |                              |
| Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti                      |                                | 1.481,0                   | 1.300,0                 | 1.048,0                  | 0,0                               | 1.048,0                            | 902,0                   | -146,0    |     |  |                                              |                              |
| Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti) |                                | 95.654,0                  | 108.320,0               | 108.068,0                | -1.136,0                          | 106.932,0                          | 95.356,0                | -11.576,0 |     |  |                                              |                              |

|                                                      |       |                                               |  |       |        |  |
|------------------------------------------------------|-------|-----------------------------------------------|--|-------|--------|--|
| Nepunesi<br>Zbatues/<br>Kryetar<br>Deges<br>Buxhetit | Emri  | Nepunesi<br>Autorizues/Kryetari i<br>Gjykates |  | Emri  | Durrës |  |
|                                                      | Firma |                                               |  | Firma |        |  |
|                                                      | Data  |                                               |  | Data  |        |  |



Republika e Shqipërisë  
Këshilli i Lartë Gjyqësor  
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

ANEKSI nr.4 "Projektet e investimeve me financim të brendshëm"

Projektet me financim të brendshëm (në 000/leke)

Perioda Janar- DHJETOR 2020

| Kodi projektit     | Emertimi i projektit               | Vlera e plotë e projektit | Viti i fillimit të projektit | Viti i përfundimit të projektit | Buxheti viti 2020 Kontraktuar | Plani i buxhetit viti 2020 | REALIZIMI nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale | REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore) | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | Komente                                                                                                                    |
|--------------------|------------------------------------|---------------------------|------------------------------|---------------------------------|-------------------------------|----------------------------|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| M290066            | Projekt                            | 10300                     |                              |                                 | 0                             | 10300                      | 0                                                       |                                                         |                                                                       | Pezulluar me Vendim të KLGJ                                                                                                |
| M290068            | Rikonstruksion                     | 385                       |                              |                                 | 0                             | 385                        | 0                                                       |                                                         |                                                                       | Realizuar me shpenzime operative 602                                                                                       |
| M290072<br>M290075 | Blerje pajisje<br>Blerje automjete | 2.970                     | 2020                         | 2020                            | 2.584                         | 2.970                      | 2.584                                                   | 2.584                                                   | 2.584                                                                 | Blerja e mobiljeve dhe e baterive është realizuar , ndërsa tenderi elektronikë është ankimuar në KPP, pritet vendimi i saj |
|                    |                                    | 13.655                    |                              |                                 | 2.584                         | 13.655                     | 2.584                                                   | 2.584                                                   | 2.584                                                                 |                                                                                                                            |

|                                             |       |                                                   |       |
|---------------------------------------------|-------|---------------------------------------------------|-------|
| Nepunesi Zbatues/ Kryetar<br>Deges Buxhetit | Emri  | Nepunesi<br>Autorizues/Kr<br>yetari i<br>Gjykatës | Emri  |
|                                             | Firma |                                                   | Firma |
|                                             | Data  |                                                   | Data  |





ANEXSI nr.4 "Projektit e investimeve me financim nga buxheti"

Projektit me financim te brendshëm (në 000/leke)  
Periudha Janar- DHJETOR 2020

| Kodi projektit | Emertimi i projektit | Vlera e plotë e projektit | Viti i fillimit të projektit | Viti i përfundimit të projektit | Buxheti viti 2020 Kontraktuar | Plani i buxhetit viti 2020 | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në | REALIZIMI për periudhën e raportimit (4 muajore/vjetore) | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale | Komente |
|----------------|----------------------|---------------------------|------------------------------|---------------------------------|-------------------------------|----------------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------|
| M290087        | Ndërtim godine       |                           |                              |                                 |                               |                            |                                                 |                                                          |                                                                       |         |
| M290068        | Rikonstruksion       |                           |                              |                                 |                               |                            |                                                 |                                                          |                                                                       |         |
| M290072        | Blerje pajisje       | 150                       | 2020                         |                                 |                               | 500                        | 17                                              | 17                                                       | 17                                                                    |         |
| M290075        | Blerje automjete     |                           |                              |                                 |                               |                            |                                                 |                                                          |                                                                       |         |

|                                          |       |  |                                        |       |  |
|------------------------------------------|-------|--|----------------------------------------|-------|--|
| Nepunesi Zbatues/ Kryetar Degës Buxhetit | Emri  |  | Nepunesi Autorizues/Kryetar i Gjykatës | Emri  |  |
|                                          | Firma |  |                                        | Firma |  |
|                                          | Data  |  |                                        | Data  |  |

